
INTEGRITETI, MERITOKRACIA DHE AUTONOMIA NË QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI

Zhvillimet post-zgjedhjeve parlamentare 2025 dhe implikimet për demokracinë lokale

Raport Analitik¹ nga eksperti Agron Haxhimali²

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport analizon zhvillimet e fundit në qeverisjen vendore në Shqipëri pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025, me fokus të veçantë në proceset e shkarkimeve kolektive, emërimeve të reja dhe respektimit të legjislacionit në fuqi. Analiza vlerëson nëse këto procese përputhen me parimet e integritetit, meritokracisë dhe shtetit të së drejtës, si dhe shqyrton implikimet e tyre për demokracinë vendore dhe mirëqeverisjen lokale.

Procesi i shkarkimeve kolektive të zv/kryetarëve dhe administratorëve

Pas kërkesave publike të Kryeministrit drejtuar të gjithë kryetarëve të 61 bashkive, u zbatua një proces i koordinuar shkarkimesh kolektive, kryesisht në bashkitë e drejtuara nga e majta. Këto shkarkime u realizuan në mënyrë të njëtrajtshme dhe të përshpejtuar, pa dokumentim të vlerësimeve individuale të performancës dhe pa ndjekur procedurat disiplinore të parashikuara nga ligji. Si pasojë, përgjegjësia administrative u zhvendos nga niveli vendor drejt autoritetit politik qendror, duke cenuar autonominë funksionale të bashkive dhe duke krijuar pasiguri institucionale.

Procesi i emërimit të drejtuesve të rinj

Emërimet pas shkarkimeve kolektive u karakterizuan nga mungesa e standardeve të qarta meritokratike, transparencës dhe legjitimitetit institucional. Në shumicën e rasteve, nuk u aplikuan

¹ Raporti bëhet në kuadër të projektit që po zbaton ISP “**Promovimi dhe llogaridhënia e zyrtarëve të zgjedhur 2025–2027**”, mbështetur nga **National Endowment for Democracy (NED)**.

² Agron Haxhimali është ekspert mbi qeverisjen vendore, drejtues i IBSH (Instituti për Bashkitë Shqiptare), autor i disa studimeve, raporteve dhe analizave mbi problematikat vendore.

procedura të hapura apo konkurruese dhe kriteret e përzgjedhjes nuk u bënë publike. Kjo praktikë tregon një prirje drejt politizimit të administratës vendore, në dëm të profesionalizmit, kapaciteteve institucionale dhe besimit të qytetarëve në institucionet lokale.

Procesi i emërimeve dhe shkarkimeve nga kryetarët e rinj të zgjedhur në zgjedhjet e pjesshme

Kryetarët e rinj të bashkive, të zgjedhur përmes zgjedhjeve të pjesshme dhe me mandate të kufizuara në kohë, ushtruan kompetencat e tyre në një kontekst presioni politik dhe pasigurie institucionale. Në disa bashki u evidentuan shkarkime dhe riorganizime të nxituara të administratës, të cilat rrezikojnë vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe kufizojnë mundësinë për planifikim afatmesëm dhe afatgjatë në nivel vendor.

Respektimi i legjislacionit në fuqi: praktika të mira dhe praktika negative

Analiza e evidenton një nivel të ulët respektimi të kuadrit ligjor që rregullon administratën vendore, përfshirë Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore, Ligjin për Nëpunësin Civil dhe Kodin e Punës, Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës si dhe normat dhe praktikën e përditshme. Praktikën negative përfshijnë ndërhyrje politike në kompetenca ekskluzive vendore, mosrespektim të statusit të nëpunësit civil dhe rritje të numrit të padive gjyqësore ndaj bashkive për largime të paligjshme nga puna. Ndërkohë, janë identifikuar raste të izoluar ku kryetarë bashkish kanë respektuar procedurat ligjore dhe kanë refuzuar zbatimin e urdhrave politikë, duke demonstruar se zbatimi i ligjit është i mundur edhe në kushte presioni.

Vlerësim i përgjithshëm

Në tërësi, këto zhvillime tregojnë një dobësim sistematik të parimeve të integritetit, meritokracisë dhe autonomisë vendore. Nëse këto praktika vijojnë, ato rrezikojnë të dëmtojnë seriozisht demokracinë vendore, cilësinë e shërbimeve publike dhe përputhshmërinë e Shqipërisë me standardet evropiane, veçanërisht në kontekstin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe në prag të zgjedhjeve vendore të vitit 2027. Raporti e evidenton se ndërhyrjet politike të artikuluar publikisht nga Kryeministri Edi Rama, të adresuara drejtpërdrejt ndaj të gjithë kryetarëve të 61 bashkive, kanë krijuar një model të centralizimit de facto të pushtetit vendor, në kundërshtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe standardet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

I. Hyrje dhe kontekst institucional

Reforma territoriale e vitit 2015 synoi forcimin e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së kapaciteteve administrative, konsolidimit financiar dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Megjithatë, që prej zbatimit të saj, është vërejtur një tendencë graduale e ri-centralizimit të kompetencave dhe vendimmarrjes, e cila është intensifikuar ndjeshëm gjatë vitit 2025 apo me saktë gjatë verës së këtij viti. Por fokusi në këtë analizë ka të bëjë me nismën dhe kërkesën e

Kryeministrit Rama drejtuar 61 kryetarëve të bashkive gjatë një takimi në Durrës³ me 11 Qershor 2025.

Procesi i shkarkimeve kolektive të zv/kryetarëve dhe administratorëve pas kërkesës së Kryeministrit

Procesi i shkarkimeve kolektive të kryetarëve të njësive administrative dhe drejtuesve vendorë mori formë pas një kërkesë të drejtpërdrejtë dhe publike të Kryeministrit Edi Rama, bërë gjatë një mbledhjeje me kryetarët e bashkive në Durrës. Në këtë takim, Kryeministri vendosi një ultimatum të qartë kohor, duke kërkuar që “deri ditën e hënë” të gjithë kryetarët e njësive administrative të Republikës së Shqipërisë të ishin të shkarkuar. Karakteristika kryesore e këtij procesi është natyra kolektive dhe e njëtrajtshme e shkarkimeve, (precedent në 35 vite demokraci ne Shqipëri, i pa aplikuar në asnjë vend tjetër në rajon apo me gjërë) e cila përjashton çdo formë vlerësimi individual të performancës apo përgjegjesisë administrative. Kërkesa nuk u bazua në procedura disiplinore, analiza funksionale apo auditime të dokumentuara, por në një urdhër politik me zbatim të menjëhershëm⁴. Kjo qasje bie ndesh me parimet themelore të administratës publike, sipas të cilave përgjegjësia është individuale dhe e bazuar në kritere objektive. Deklarata e Kryeministrit, sipas së cilës drejtuesit e shkarkuar “do të kenë mundësinë të rikandidojnë përpara të tjerëve”⁵, sugjeron një proces rikonfirmimi që nuk përputhet me standardet e meritokracisë dhe konkurrencës së hapur. Përkundrazi, ajo krijon perceptimin e një procesi selektiv politik, ku besnikëria dhe afërsia politike rrezikojnë të prevalojnë mbi aftësitë profesionale dhe përvojën administrative. Nga pikëpamja institucionale, ky proces ka zhvendosur përgjegjësinë administrative nga niveli vendor drejt autoritetit politik qendror, duke cenuar autonominë funksionale të bashkive dhe rolin kushtetues të kryetarëve të zgjedhur. Zbatimi selektiv i këtij ultimatum, kryesisht në bashkitë e drejtuara nga e majta, forcon perceptimin e një praktike politike dhe jo administrative, me pasoja të drejtpërdrejta për stabilitetin institucional, sigurinë e administratës vendore dhe cilësinë e shërbimeve publike për qytetarët.

II. Procesi i shkarkimeve kolektive në bashkitë e majta

Pas kërkesave publike të Kryeministrit drejtuar kryetarëve të bashkive, u ndërmor një proces shkarkimesh masive dhe të sinkronizuara, kryesisht në bashkitë e drejtuara nga e majta, që përfshiu: nënkryetarë bashkish; administratorë të njësive administrative; drejtues të lartë vendorë. Ky proces u karakterizua nga: mungesë e vlerësimit individual të performancës;

³ Reporter. Link: <https://www.reporter.al/2025/07/11/shteti-ne-nje-dore-urdhri-i-rames-per-shkarkimin-e-administratoreve-pritet-me-shqetesim/>

⁴ TV Klan. Link: <https://tvklan.al/rama-te-shkarkohen-te-gjithe-kryetaret-e-njesive-administrative>

⁵ Gazeta Panorama. Link: <https://www.panorama.com.al/kryeministri-edi-rama-ultimatum-deri-diten-e-hene-te-gjithe-kryetaret-e-njesive-administrative-te-jene-te-shkarkuar/>

mungesë e procedurave disiplinore të parashikuara nga ligji; zbatim politik dhe jo administrativ i përgjegjesisë.

Si rezultat i ndërhyrjeve politike, përgjegjësia institucionale u zhvendos nga niveli vendor drejt presionit politik qendror, duke cenuar drejtpërdrejt parimin e autonomisë funksionale të bashkive. Në këtë kontekst, u evidentuan edhe lëvizje të ndërmarra “për hatër nga halli”, si pasojë e presionit politik, të cilat në praktikë mbetën formale dhe të përkohshme. Këto përfshinë largimin për pak ditë të disa zëvendëskryetarëve, të ndjekur nga rikthimi i tyre në detyrë, apo riorgazime administrative që nuk shërbyen as interesit publik dhe as një qarkullimi racional të burimeve njerëzore. Një analizë e thjeshtë statistikore e bën të dukshme mospërputhjen mes urdhrit politik dhe realitetit institucional. Nëse kërkesa e Kryeministrit do të ishte zbatuar realisht dhe në mënyrë të plotë, ajo do të duhej të sillte largimin e menjëhershëm të rreth 130-150 zv/kryetarëve (duke qenë se 61 bashki kanë mesatarisht 2-3 zëvendëskryetarë secila), rreth 300 administratorëve të njësisve administrative (nga afërsisht 340 njësi administrative në shkallë vendi), si dhe rreth 300 drejtuesve kryesorë të drejtorive (bazuar në strukturat organizative standarde me të paktën 5 drejtori për bashki).

Fakti që këto shifra nuk u materializuan në praktikë tregon disa elemente thelbësore. Së pari, si niveli qendror që ushtroi presionin politik, ashtu edhe një pjesë e kryetarëve të bashkive, e trajtuan administratën vendore jo si administratë publike dhe civile, por si administratë politike, e varur nga direktivat dhe jo nga ligji. Së dyti, nga pikëpamja procedurale, është teknikisht dhe ligjërish e pamundur të realizohen emërime dhe shkarkime masive të këtij niveli brenda një harku kohor prej 48 orësh, pa shkelur në mënyrë flagrante procedurat ligjore, rregulloret vertikale të administratës publike dhe aktet e brendshme organizative të vetë bashkive. Në këtë kuptim, procesi nuk përfaqëson një reformë administrative të mirëfilltë, por një ndërhyrje politike të pa ankoruar në ligj, që prodhoi veprime formale, kontradiktore dhe shpesh të kthyeshme, duke cenuar parimet e ligjshmërisë, stabilitetit administrativ dhe mirëqeverisjes vendore.

Reagimi i bashkive të opozitës⁶

Pas ultimatumave publike të Kryeministrit Edi Rama për shkarkimin e zv/kryetarëve të bashkive dhe administratorëve, disa kryetarë bashkish të opozitës reagues publikisht duke refuzuar zbatimin e urdhrave politikë dhe duke theksuar se vendimmarrja në administratë duhet të bazohet në performancë dhe kompetencë, jo në direktiva nga pushteti qendror. Kryetarë bashkish si Kavaja, Himara, Fushë-Arrëz dhe Mirdita apo Konispol (PS) riafirmuan parimin e autonomisë vendore dhe rolin e kryetarit si autoritet ligjor për emërimet dhe shkarkimet.

⁶ TV Euronews. <https://euronews.al/rama-kerkoi-shkarkimin-e-nenkryebashkiavevedemokratet-nuk-ndjekim-urdhera-politike/>

Megjithatë, edhe pse ky qëndrim u artikulua publikisht, në prapavijë janë evidentuar lëvizje administrative të padeklaruara, të ndërmarra nga disa bashki, të cilat de facto përputhen me kërkesat e Kryeministrit, por pa e pranuar publikisht këtë lidhje. Kjo situatë tregon, njëkohësisht, autoritetin e tepruar të Kryeministrit në raport me pushtetin vendor dhe dobësinë e autoritetit real institucional të disa kryetarëve bashkish, të cilët ndodhen mes presionit politik qendror dhe përgjegjësisë ligjore që u jep mandati i qytetarëve. Këto zëra opozitarë, edhe pse të vakët, përcollën mesazhin e respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

III. Procesi i emërimit të drejtuesve të rinj

Procesi i emërimit të drejtuesve të rinj: mungesë meritokracie, transparence dhe legjitimiteti institucional (me analizë krahasuese) Procesi i emërimit të drejtuesve të rinj në administratën vendore, i ndërmarrë pas shkarkimeve kolektive, ka ngritur shqetësime serioze lidhur me respektimin e parimeve themelore të qeverisjes së mirë dhe administratës publike profesionale. Siç theksohet edhe në deklaratën e Instituti për Bashkitë Shqiptare⁷, ndërhyrjet e drejtpërdrejta politike në emërimet vendore përbëjnë shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve dhe cenim të autonomisë vendore, të garantuar nga Kushtetuta dhe nga Karta Evropiane e Autonomisë Vendore. Në praktikë, emërimet e reja nuk janë paraprirë nga procedura të hapura konkurruese, kriteret të qarta përzgjedhjeje apo mekanizma transparentë vlerësimi. Mungesa e këtyre elementeve e largon procesin nga standardet ndërkombëtare të administratës publike, ku rekrutimi dhe emërimi në nivel vendor duhet të bazohen në meritë, profesionalizëm dhe barazi në akses, në përputhje me parimet e promovuara nga OECD⁸ dhe Council of Europe.

Analizë krahasuese me praktikat evropiane

Në shumicën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, emërimet në administratën vendore janë të ndara qartë nga ndikimi politik qendror. Në Gjermani, kryetarët e bashkive gëzojnë autonomi të plotë në emërimet administrative, por këto realizohen përmes procedurave konkurruese të rregulluara me ligj, ku kriteret profesionale dhe përvoja administrative janë detyruese. Çdo ndërhyrje e qeverisë federale apo të landeve në emërimet do të konsiderohej shkelje e parimit kushtetues të vetëqeverisjes lokale (*kommunale Selbstverwaltung*). Në Francë, edhe pse sistemi është më i centralizuar, emërimet në administratën komunale mbrohen nga një shërbim civil i fortë dhe i depolitizuar; ndërhyrjet politike në emërimet

⁷ Instituti për Bashkitë Shqiptare. Deklarate. Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=761829443039216&set=a.180596714495828>

⁸ SIGMA. Link: https://www.sigmaweb.org/content/dam/sigma/sq/publications/reports/2023/11/the-principles-of-public-administration_5e68f805/c3dda49a-sq.pdf

administrative janë të kufizuara dhe të kontrolluara rreptësisht nga gjykatat administrative. Në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si Polonia apo Çekia, praktikat e politizimit të emërimeve vendore janë identifikuar si rrezik për kapjen e institucioneve lokale dhe janë kritikuar vazhdimisht në raportet e monitorimit të Këshillit të Evropës dhe të Komisionit Evropian. Por edhe në një krahasim më të afërt, me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht me Kosovën, qeverisja vendore dhe demokracia lokale atje paraqesin një nivel performancë më të lartë.

Në këtë kontekst krahasues, praktika e emërimeve në Shqipëri devijon nga standardet evropiane, pasi kombinon presion politik qendror, mungesë procedurash meritokratike dhe dobësim të rolit të kryetarëve të zgjedhur si autoritet ligjor i administratës dhe si i vetmi që zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetaret. Kjo qasje jo vetëm që cenon integritetin institucional, por rrezikon të krijojë një administratë vendore të varur politikisht, me kapacitete të dobëta profesionale dhe me legjitimitet të kufizuar në sytë e qytetarëve.

Nga perspektiva e integritetit evropian, politizimi i emërimeve në nivel vendor përbën një sinjal negativ për respektimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe qeverisjes demokratike, duke e bërë këtë çështje jo vetëm një problem të brendshëm administrativ, por një çështje me relevancë direkte për procesin e negociatave me Bashkimin Evropian. Pra, procesi pasues i emërimeve të reja ka ngritur shqetësime serioze lidhur me: a-mungesën e standardeve meritokratike; b-mungesën e procedurave transparente dhe konkurruese; c-legjitimitetin profesional së të emëruarve. Në shumë raste, emërimet janë perceptuar si zëvendësime politike, më tepër sesa reforma administrative të bazuara në integritet dhe kapacitete profesionale. Kjo praktikë dobëson administratën vendore dhe ul besimin e stafit dhe qytetarëve në institucionet lokale.

IV. Emërimet dhe shkarkimet nga kryetarët e rinj të zgjedhur në zgjedhjet e pjesshme

Zgjedhjet e pjesshme në 6 bashki⁹: dobësi institucionale, mungesë koordinimi dhe implikime për qeverisjen demokratike. Zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të planifikuara për nëntor 2025 përbëjnë një zhvillim me relevancë të gjerë kombëtare, duke pasur parasysh se ato përfshijnë mbi 33% të popullsisë së vendit. Përtej dimensionit zgjedhor, ky proces ekspozon dobësi strukturore në funksionimin e institucioneve, si dhe sfida të vazhdueshme në garantimin e stabilitetit institucional dhe qeverisjes efektive në nivel vendor.

Vakanca të qarta dhe dështim i zinxhirit institucional

⁹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Link: <https://kqz.gov.al/lajme/zgjedhjet-e-pjesshme-te-dates-9-nentor-2025-kshz-miraton-sasine-e-fleteve-te-votimit-qe-do-te-prodhohen>

Në rastin e bashkive Mat, Tepelenë dhe Berat, vakanca në postin e kryetarit të bashkisë ishte qartësisht e identifikueshme dhe e dokumentuar, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore. Megjithatë, procesi institucional për njoftimin, aktivizimin dhe koordinimin e zgjedhjeve të pjesshme nuk funksionoi në mënyrë efektive dhe në përputhje me afatet ligjore të Kodit Zgjedhor¹⁰.(Një aspekt thelbësor i përfundimit para kohe të mandatit është organizimi i zgjedhjeve të pjesshme. Kodi Zgjedhor në nenin 10, pika 3, përcakton që zgjedhjet duhet të mbahen jo më parë se 30 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e njoftimit zyrtar të përfundimit të mandatit.)Ky mosfunksionim reflekton një mungesë koordinimi ndërinstitutional, si dhe kapacitete të pamjaftueshme për të garantuar zbatimin e ligjit në kohë. Nga perspektiva e standardeve të Bashkimit Evropian, vonesat e pajustificuara në aktivizimin e mekanizmave zgjedhorë përbëjnë një dobësi në respektimin e parimit të sigurisë juridike dhe krijojnë vakuam institucional në nivel vendor. Në këtë kontekst, pritshmëria ishte që institucionet qendrore, përfshirë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, të ushtronin në mënyrë proaktive përgjegjësitë e tyre kushtetuese për të garantuar funksionimin normal të pushtetit vendor dhe vazhdimësinë e përfaqësimit demokratik. Mosveprimi ose veprimi i vonuar bie ndesh me parimin e llogaridhënies dhe dobëson besimin në institucionet publike.

Apati politike dhe dobësi e kontrollit demokratik

Paralelisht me këto dështime institucionale, partitë opozitare shfaqën një nivel të ulët angazhimi politik dhe institucional për të kërkuar respektimin e afateve ligjore dhe për të ushtruar funksionin e tyre mbikëqyrës. Në terminologjinë e raporteve të Komisioni Evropian, kjo situatë përfaqëson një dobësi në checks and balances, ku mungesa e presionit politik kontribuon në normalizimin e praktikave joefektive dhe të vonuara. Një demokraci funksionale kërkon opozitë aktive dhe institucione që ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm mbi zbatimin e ligjit. Mungesa e këtij roli përkeqëson perceptimin e llogaridhënies politike dhe cenon cilësinë e procesit demokratik në nivel vendor.

Vendimmarrje selektive dhe ndikim i interesave politike

Në kontrast me rastet ku vakanca ishte e qartë dhe e zgjatur, për bashki si Vlora dhe Cërriku, ndërprerja e mandatit ndodhi në një fazë më të vonë dhe në një kontekst që perceptohet gjerësisht si politik. Nga perspektiva e qeverisjes së mirë, këto situata mund të ishin menaxhuar në mënyrë alternative, duke garantuar vazhdimësinë e qeverisjes vendore deri në zgjedhjet e rregullta.

Rasti i Bashkisë Tiranë: pasiguri ligjore, keqinterpretim institucional dhe rrezik për standardet e qeverisjes demokratike

¹⁰ OSCE Albania. Link: <https://www.osce.org/sites/default/files/f/documents/5/7/477547.pdf>

Rasti i Bashkisë Tiranë përfaqëson shembullin më kompleks dhe më të ndjeshëm të debatit mbi zgjedhjet e pjesshme, për shkak të peshës politike, institucionale dhe demografike që ka kryeqyteti në sistemin e qeverisjes vendore. Pas arrestimit të kryetarit të bashkisë, Erion Veliaj, u hap një debat publik dhe institucional mbi mundësinë e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme, debat që nxori në pah paqartësi ligjore dhe mungesë koherence në veprimet e institucioneve. Nga pikëpamja ligjore, arrestimi i kryetarit të bashkisë nuk përbën automatikisht përfundim të mandatit, pasi masa e arrestit është një masë sigurie dhe jo një vendim penal i formës së prerë. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton qartë rastet kur mandati përfundon para afatit, ndër të cilat përfshihen dorëheqja, dënimi me vendim gjykate të formës së prerë, shkarkimi për shkelje të rënda, apo mosparaqitja në detyrë për më shumë se tre muaj rresht, sipas procedurave të parashikuara.

- V. Në kushtet aktuale, për sa kohë nuk ka dorëheqje, nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk është ndjekur procedura e shkarkimit sipas nenit 62 të ligjit, mandati i kryetarit teknikisht vijon, ndërsa funksionet e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari. Si rrjedhojë, vakanca ligjore nuk është e qartë dhe e konfirmuar, çka e bën çdo iniciativë për dekretimin e zgjedhjeve të pjesshme juridikisht të pambështetur. Në këtë kontekst, ajo që bie në sy është një papjekuri institucionale në nivelet më të larta të arkitekturës shtetërore, ku janë artikulluar ose ndërmarrë iniciativa politike për zgjedhje të pjesshme pa plotësimin paraprak të kushteve ligjore për shpalljen e vakancës. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe me standardet e qeverisjes së mirë, të cilat kërkojnë që proceset zgjedhore të bazohen në rrethana të qarta ligjore dhe jo në interpretime të zgjeruara apo presion politik.

Në analizat krahasuese të qeverisjes demokratike, institucioni i dorëheqjes konsiderohet një mekanizëm i rëndësishëm i integritetit institucional dhe përgjegjshmërisë politike, veçanërisht në rastet kur ushtrimi efektiv i mandatit pengohet në mënyrë të zgjatur. Në shumë demokraci evropiane, dorëheqja nuk interpretohet si pranim faji penal, por si akt politik dhe institucional, që synon mbrojtjen e funksionimit normal të institucionit dhe ruajtjen e besimit publik. Në këtë kuptim, edhe pse ligjërisht arrestimi nuk sjell automatikisht përfundimin e mandatit, nga perspektiva e etikës publike dhe qeverisjes së mirë, dorëheqja mbetet një opsion legjitim dhe i respektuar ndërkombëtarisht, kur mungesa e zgjatur rrezikon të krijojë pasiguri institucionale ose të politizojë tej mase funksionimin e bashkisë. Nga perspektiva e standardeve evropiane, veçanërisht atyre të Komisionit Evropian mbi funksionimin e institucioneve demokratike, rasti i Tiranës evidenton rrezikun e politizimit të procedurave ligjore, ku zgjedhjet e pjesshme trajtohen si instrument politik dhe jo si mekanizëm për garantimin e vazhdimësisë institucionale. Normalizimi i një qasjeje të tillë do të cenonte besimin e qytetarëve, autonominë vendore dhe parimin e parashikueshmërisë në qeverisjen e kryeqytetit.

Në përfundim, rasti i Bashkisë Tiranë nënvizon nevojën për respektim strikt të kuadrit ligjor, vetëpërmbajtje institucionale dhe ndarje të qartë mes proceseve penale, administrative dhe zgjedhore. Paralelisht, ai rikthen në vëmendje rëndësinë e standardeve të integritetit dhe përgjegjshmërisë politike, përfshirë përdorimin e dorëheqjes si instrument etik, në funksion të

stabilitetit institucional dhe përputhshmërisë së Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian. Raportet e Komisionit Evropian theksojnë vazhdimisht rëndësinë e vazhdimësia institucionale dhe parashikueshmëria në qeverisje¹¹. Vendimmarrja selektive dhe e fragmentuar rrezikon të dëmtojë stabilitetin administrativ, të vonojë zbatimin e politikave publike dhe të ndikojë negativisht në cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

VI. Implikime për qytetarin dhe procesin e integritit evropian

Në tërësi, këto zhvillime tregojnë: zbatim të paqëndrueshëm të kuadrit ligjor; dobësi në koordinimin ndërinstitucional; mungesë të vazhdimësisë në qeverisjen vendore; rrezik për uljen e besimit të qytetarëve në institucionet demokratike. Nga perspektiva e integritit evropian, këto çështje lidhen drejtpërdrejt me kriteret politike të anëtarësimit, veçanërisht me funksionimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit dhe administratën publike efektive. Adresimi i tyre kërkon përmirësim të kapaciteteve institucionale, respektim rigoroz të afateve ligjore dhe forcim të mekanizmave të llogaridhënies, në përputhje me standardet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Zgjedhjet e pjesshme kanë prodhuar një efekt të drejtpërdrejtë në funksionimin e bashkive, duke vendosur kryetarët e rinj përballë mandateve të shkurtra, presionit të vazhdueshëm politik dhe një mjedisi të theksuar pasigurie institucionale. Në këtë kontekst, në disa bashki janë vërejtur vendimmarrje të nxituara administrative, përfshirë shkarkime dhe riorganizime¹² të shpejta, shpesh pa analiza funksionale të mjaftueshme. Këto zhvillime kanë rritur rrezikun për ndërprerje të vazhdimësisë administrative dhe ulje të cilësisë së shërbimeve publike. Në terma të qeverisjes së mirë, efekti kumulativ i zgjedhjeve të pjesshme ka qenë dobësimi i stabilitetit institucional dhe i parashikueshmërisë në nivel vendor.

VII. Respektimi i legjislacionit në fuqi: praktika të mira, praktika negative dhe implikimet për demokracinë vendore

Analiza e zhvillimeve post-zgjedhjeve parlamentare 2025 (në përgjithësi është praktikë historike) tregon influencë politike në emërimet dhe shkarkimet në pushtetin vendor me një prirje të dukshme drejt tejkalimit të parimeve të integritetit dhe meritokracisë. Kuadri ligjor shqiptar përcakton qartë kompetencat, procedurat dhe garancitë institucionale për administratën vendore, duke u mbështetur në tre kolona kryesore:

¹¹ EU Commission, Report on Albania. Link: https://commission.europa.eu/projects/enhancing-predictability-and-efficiency-decision-making-processes-strengthening-capacity-policy_en

¹² Lapsi.al. Link: <https://lapsi.al/2025/12/09/jep-doreheqjen-nenkryetari-i-bashkise-se-vlores-elis-halili/>

- (i) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 108-115 Qeverisja Vendore),
- (ii) Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- (iii) Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe
- (iv) Kodi i Punës

Praktika negative dominuese

Në praktikë, një pjesë e konsiderueshme e emërimeve dhe shkarkimeve të ndërmarra pas zgjedhjeve janë realizuar nën presion politik siç analizuam më sipër, pa respektuar parimin e përgjegjësisë individuale dhe procedurat e parashikuara nga ligji. Janë evidentuar raste të urdhrave politik te: shkarkimeve kolektive pa vlerësim individual performance; anashkalimit të statusit të nëpunësit civil dhe garancive procedurale; përdorimit të riorganizimeve administrative si mjet për zëvendësim politik; rritjes së padive gjyqësore ndaj bashkive për largime të paligjshme, me kosto financiare dhe institucionale. Këto praktika bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjin për vetëqeverisjen vendore, të cilat sanksionojnë autonominë organizative dhe funksionale të bashkive, si dhe me parimet e shërbimit civil profesional, të bazuar në meritë, stabilitet dhe neutralitet politik.

Praktika të mira (të kufizuara dhe jo sistematike¹³)

Paralelisht, janë identifikuar edhe praktika pozitive, megjithëse të izoluara, ku disa kryetarë bashkish: kanë refuzuar zbatimin e urdhrave politikë; kanë kryer vlerësime individuale të performancës; kanë respektuar procedurat ligjore për emërime dhe shkarkime. Këto raste demonstrojnë se zbatimi i ligjit është i mundur edhe në kushte presioni politik, por mungesa e një qasjeje të unifikuar i bën ato përjashtim dhe jo standard funksional.

Integriteti dhe Meritokracia në qeverisjen vendore

Në thelb, zhvillimet e vitit 2025 tregojnë një dobësim sistematik të integritetit dhe meritokracisë në qeverisjen vendore. Emërimet dhe shkarkimet janë orientuar më shumë nga konsiderata politike sesa nga kriteret profesionale dhe nevojat funksionale të administratës. Kjo qasje cenon parimet kushtetuese të vetëqeverisjes vendore dhe bie ndesh me standardet evropiane të administratës publike, ku meritokracia dhe stabiliteti institucional janë elementë kyç të sundimit të ligjit.

Impakti për demokracinë vendore dhe mirëqeverisjen lokale

Nga perspektiva e demokracisë vendore, praktikat e evidentuara gjatë vitit 2025 kanë prodhuar një dobësim të ndjeshëm të autonomisë reale të bashkive, reduktim të rolit të kryetarëve dhe

¹³ TV Euronews. Link: <https://euronews.al/rama-kerkoi-shkarkimin-e-nenkryebashkiakevedemokratet-nuk-ndjekim-urdhera-politike/>

këshillave bashkiakë si organe të zgjedhura dhe rritje të pasigurisë institucionale. Ndërprerjet e shpeshta në drejtimin administrativ dhe politizimi i vendimmarrjes kanë ndikuar negativisht në vazhdimësinë administrative dhe kanë kontribuar në rënie të besimit të qytetarëve në institucionet lokale. Në terma të mirëqeverisjes, politizimi i administratës vendore ka sjellë ulje të cilësisë dhe parashikueshmërisë së shërbimeve publike, rritje të kostove financiare dhe administrative, si dhe dobësim të mekanizmave të llogaridhënies lokale. Këto zhvillime bien ndesh me parimet e administratës publike profesionale dhe me standardet e qeverisjes së mirë të promovuara nga Bashkimi Evropian.

Kjo situatë është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se rreth 70% e legjislacionit të Bashkimit Evropian zbatohet në nivel vendor, përfshirë politika dhe standarde që lidhen me mjedisin, shërbimet publike, prokurimin, ndihmën shtetërore, kohezionin social dhe zhvillimin territorial. Si rrjedhojë, kapaciteti i bashkive për të zbatuar në mënyrë efektive, të paanshme dhe profesionale *acquis communautaire* është drejtpërdrejt i lidhur me nivelin e integritetit institucional, meritokracisë dhe autonomisë funksionale të pushtetit vendor. Respektimi selektiv i kuadrit ligjor në emërimet dhe shkarkimet vendore tregon mungesë të balancimit të pushteteve dhe dobësi në koordinimin institucional, duke rritur rrezikun e ndërhyrjeve politike që cenojnë zbatimin e politikave publike në interes të qytetarëve, por kanë dhe pasoja ekonomike që për nivelin ekonomik të Shqipërisë përbëjnë një stres të madh financiar¹⁴. Në këtë kontekst, Bashkimi Evropian thekson vazhdimisht nevojën për institucione vendore të pavarura, profesionale dhe të mbrojtura nga ndikimi politik, si parakusht për sundimin e ligjit dhe funksionimin efektiv të demokracisë.

Në përfundim, pa një rikthim të plotë të ligjshmërisë, meritokracisë dhe integritetit institucional si standarde funksionale dhe jo thjesht formale demokracia vendore dhe mirëqeverisja lokale rrezikojnë të mbeten të brishta dhe të ekspozuara ndaj ndërhyrjeve politike afatshkurtra. Një qeverisje vendore e bazuar në moralitet publik, ndarje të qartë pushtetesh, koordinim institucional dhe vetëpërbajtje politike është thelbësore jo vetëm për cilësinë e shërbimeve publike, por edhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

VIII. Gjetje kryesore

1. Ndërhyrjet politike kanë krijuar një model të qëndrueshëm centralizimi që cenon autonominë vendore.
2. Meritokracia dhe stabiliteti administrativ janë zëvendësuar nga logjika e besnikërisë politike.

¹⁴ Revista Monitor. Link: <https://monitor.al/statistika-largimet-nga-puna-demshperblimet/>

3. Demokracia lokale dhe cilësia e shërbimeve publike janë drejtpërdrejt të rrezikuara.

Rekomandime (në kontekstin e negociatave me BE dhe deri në zgjedhjet vendore 2027)

1. Vendosja e një mekanizmi të pavarur monitorimi të ndërhyrjeve në pushtetin vendor deri në zgjedhjet vendore 2027.
2. Dokumentimi sistematik i rasteve, marrja e shpjegimeve zyrtare dhe adresimi institucional i shkeljeve.
3. Përfshirja e gjetjeve në raportimet ndërkombëtare, përfshirë raportet e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

IX. Konkluzione

Autonomia vendore nuk është privilegj politik, por një e drejtë kushtetuese dhe evropiane. Mbrojtja e saj është thelbësore për demokracinë, mirëqeverisjen dhe procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.